

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**POCESTECH Sh.p.k**

Sot më datë 01/07/2024 ne Durres:

Z. Sabri Mullameti i lindur në Maqellare, i datelindjes 26/10/1993, i biri i Mustafa Mullameti, rezident ne Shqiperi në Rr Qazim Bici nd.24 Xhafzotaj Shijak , me nr. karte identiteti J31026009J, me cilësinë e Ortakut themelues, ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statusi i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, së cilës i bashkangjitet (më poshtë "Shtojca 1).

Z. Bledar Mullameti i lindur në Maqellare, i datelindjes 19/11/1994, i biri i Lulzim Mullameti, rezident ne Shqiperi në Rr Qazim Bici nd.26 Xhafzotaj Shijak, me nr. karte identiteti J40919012U, me cilësinë e Ortakut themelues, ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statusi i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, së cilës i bashkangjitet (më poshtë "Shtojca 1).

Neni 1- Emërtimi

1.1 Emërtimi i Shoqërisë është PocesTech shpk.

Neni 2- Selia

2.1 Selia e shoqerise eshte ne Durres, Xhafzotaj, autosdrata Tirane-Durres,mbikalimi i flakes,Zona kadestrale 2574,Kapanoni D,nr 2

2.2 Transferimi i selisë së kompanisë në një vend tjetër do të bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

2.3 Asamblea e Ortakëve mund të vendosë për hapjen e degëve, dhe përfaqësive në qytete të tjera të Shqipërisë dhe gjithashtu jashtë saj.

Neni 3- Kohezgjatja

3.1 Kohezgjatja e veprimtarisë se Shoqërisë është përcaktuar deri më 31/12/2050 .


3.2 Shoqëria mund të shpërbëhet më herët ose afati kohor mund të zgjatet me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 4- Objekti i Shoqerise

4.1 Shoqeria do te zhvillojë aktivitet me objektin e mëposhtëm:

Blerja, riparimi, shitja dhe tregtimi i makinëve per industri

. Prodhimi i perberesve te destinuara ne sektorin termohidraulik dhe automobilistik. Aktivitet i perpunimit aktiv ne Industrine Automobilistike dhe Termohidraulike. Prodhimin, montimin dhe kontrolli funksional te perberesve mekanike per industrine automobilistike dhe per te gjitha automjetet tokesore dhe llojeve te tjera industriale dhe termohidraulike. Prodhimin e pjeseve ne gome dhe material termoplastik, te tubave te ngurte dhe fleksibel kablllo dhe telekomanda mekanike kontrolli dhe cdo operacion tjeter qe lidhet me prodhimin e ketyre produkteve. Tregtimin me shumice dhe me pakice te produkteve te prodhuara dhe import-eksportin e tyre. Shoqeria mund te kryeje punime per llogari te te treteve Themeloje, te marre, direkt ose indirekt, pjesemarrje dhe interesa ne biznese te tjera. Marre persiper, per llogari te vete ose te te treteve, zbatimin e kontratave te bashkepunimit industrial dhe tregtar.



Neni 5 – Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar eshte 10.000 lekë.

5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuotë e nënshkruar dhe per tu shlyer me vlere kapitali 10.000 leke.

Neni 6 – Kontributet

6.1 Kontributi i kapitalit themeltar u ofrua si më poshtë:

Z.Sabri Mullameti, një shtetas shqiptar, ofron një kontribut në para të barabartë me 5,100 (pesëmije e njëqind) Leke;

Z.Bledar Mullameti, një shtetas shqiptar, ofron një kontribut në para të barabartë me 4,900 ( katërmijë e nëntëqind ) Leke;

7.2 Sipas kontributeve të lartpërmendura:

Z.Sabri Mullameti zotëron 1 (një) pjesë të kapitalit themeltar që korrespondon me 51% të kapitalit të shoqërisë, dhe

Z.Bledar Mullameti zotëron 1 (një) pjesë të kapitalit themeltar që korrespondon me 49% të kapitalit të shoqërisë.

Neni 7 – Transferimi i kuotave

7.1 Kuotat i transferohen te treteve sipas parashikimeve te Statutit.

Neni 8 – Administrimi

Administrator i parë i shoqërisë do të jetë: Z Sabri Mullameti, shtetas shqiptar, banues në Rr Qazim Bici nd.24 Xhafzotaj Shijak rezident në Shqipëri, me nr. Kartë identiteti J31026009J

Neni 9 – Gjuha

9.1 Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe.

ORTAKU

Z. Sabri Mullameti

Sabri Mullameti



ORTAKU

Z. Bledar Mullameti

Bledar Mullameti

